



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1369 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

VENDIM Nr. 221, datë 31.10.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi **projektin "Rikonstruksioni i Shkallareve në Sarandë", të cilat pozicionohen në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës**, paraqitur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

VENDOSI:

1. Të miratojë **projektin "Rikonstruksioni i Shkallareve në Sarandë", të cilat pozicionohen në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës**, paraqitur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit gjatë zbatimit të projektit "Rikonstruksioni i Shkallareve në Sarandë", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. DRKK Vlorë, Sektori Sarandë të informojë zyrtarisht, në mënyrë periodike, Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik për ecurinë e punimeve të zbatimit të projektit të sipërpërmendur.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrisë Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO-FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al